

## *Emrat hyjnorë të kishës (1)*

---

Dita e parë e Rrëshajëve, pas ringjalljes së Krishtit, ishte një ditë e shumëpritur. Dita me të vërtetë e rëndësishme kishte ardhur! Kjo Ditë ishte e një rëndësie të madhe dhe të pritur. Ishte dita drejt së cilës i gjithë Testamenti i Vjetër dhe misioni tokësor i Krishtit ishin përqëndruar. Profecitë e dhëna me anë të Frymës së Shenjtë shumë kohë më parë u përmbushën në këtë ditë me ardhjen e mbretërisë së Perëndisë. Misioni i Perëndisë për jetën e Jezusit në tokë ishte përgatitja e kësaj dite kaq të veçantë.

Pak kohë para se të shkonte te Ati i Tij në qiell, Krishti i urdhëroi apostujt e Tij të prisnin në Jeruzalem për të marrë premtimin e Atit (Lluka 24:46–49). Ditën e fundit, Ai u foli atyre për pagëzimin me Frymën e Shenjtë: «...që, tha Ai, e keni dëgjuar nga Unë, sepse Gjoni pagëzoi me ujë, por ju do të pagëzoheni me Frymën e Shenjtë, mbas jo shumë ditësh» (Veprat 1:4–5). Koha po afronte dhe Krishti donte të thoshte se ardhja e Frymës do të ndodhte vetëm pas disa ditësh. Dhjetë ditë më vonë apostujt u pagëzuan me Frymën e Shenjtë (Veprat 2:1–4). Pas ardhjes së Frymës mbi apostujt, apostulli Pjetër predikoi për herë të parë nga ungjilli, para mijra hebrenjve që ishin mbledhur për të parë

çfarë po ndodhte. Tre mijë hebrenj e pranuan Fjalën e Perëndisë dhe u pagëzuan në Krisht (Veprat 2:41). Kisha lindi në përputhje me planin e përjetshëm të Perëndisë. Jezusi e kishte plotësuar premtimin e Tij për të themeluar kishën (Mateu 16:18). Periudha Kristiane, periudha e fundit e historisë njerëzore, filloi me themelimin e kishës së Perëndisë.

Kisha që ndërtoi Jezusi, vihet në qendër të Testamentit të Ri. Bashkësitë e Kishës së Perëndisë shfaqen nga një qytet në tjetrin në të gjithë Perandorinë Romake. Kristianizmi shpërndahet në të gjithë botën si një zjarr i furishëm dhe burra e gra i shtohen mbretërisë së Perëndisë përmes bindjes ndaj Fjalës së Tij.

Ky fillim i kishës shtron pyetjet: «Si do të emërohet kisha që Jezusi themeloi në Testamentin e Ri?» dhe: «Si do të njihet kjo kishë?»

Një lexim i kujdesshëm i Testamentit të Ri tregon se kisha u krijua për të qenë një organizëm i veçantë dhe, si rrjedhim, emërtohet në një mënyrë të veçantë nga shkrimtarët e frymëzuar. Këto emërtime mund të ndahen në tre grupe. Ato janë përdorur për të shprehur funksion (Cili është funksioni i kishës?), pronësi (Kujt i takon kisha?) dhe marrëdhënie (midis kishës dhe Perëndisë dhe midis anëtarëve të saj me njëri-tjetrin). Ato janë dhënë nga udhëzimet hyjnore dhe plotësojnë një qëllim hyjnor.

Shikoni me kujdes emërtimet hyjnore për kishën.

### **EMËRTIMI SIPAS FUNKSIONIT**

Tre përshtimet e dhëna për kishën në Testamentin e Ri lidhen me funksionin e kishës si një trup, si një trup me jetë. Këto përshtime e bëjnë më të kuptueshme se cili është qëllimi, plani dhe veprimtaria e kishës së Perëndisë.

Së pari, ajo që Krishti themeloi, është quajtur thjesht «kisha» (Kolosianëve 1:18, 24). Kjo frazë nënkupton «një bashkësi njerëzish që janë kthyer në ndjekës të Perëndisë».

Këta njerëz janë përmendur në kuptimin e të grumbulluarit ose të mbledhurit (1 Korintasve 11:18), në kuptimin lokal (1 Korintasve 1:2), në kuptimin krahinor (1 Korintasve 16:1) dhe në kuptimin universal (Efesianëve 5:23). Ky përshkrim bën të njohur kuptimin bazë të asaj që Krishti themeloi, një grup njerëzish të shpëtuar nga gjaku i Tij që jetojnë për Të, e nderojnë dhe bëjnë punën e Tij.

Së dyti, kisha është quajtur «trupi» i Krishtit (Efesianëve 1:22–23). Ky term është përdorur disa herë si një ilustrim për funksionin e kishës (1 Korintasve 12:12–27) dhe disa herë tregon se çfarë kisha është me të vërtetë, duke folur për identifikimin e saj. Kur përdoret për të përshkruar, shprehja «trupi i Krishtit» thekson si funksionin ashtu edhe marrëdhënien: Kisha është trupi shpirtëror i Krishtit në tokë dhe është lidhur me Krishtin ashtu si trupi është i lidhur me kokën e Tij. Në këtë trup shpirtëror të Krishtit, individët kristianë duhet të funksionojnë si «anëtarë» të trupit, ku çdo kristian është një anëtar dhe punon si pjesë e trupit. Pali shkroi për kishën në Korinth: «Dhe ju jeni trupi i Krishtit dhe gjymtyrët e Tij, veç e veç» (1 Korintasve 12:27).

Së treti, kisha është quajtur «mbretëria» (Veprat 8:12). Disa herë shprehja e përdorur është «mbretëria e qiellit» (Mateu 16:18–19) dhe disa herë është «mbretëria e Perëndisë» (Gjoni 3:3). Të dyja shprehjet reflektojnë natyrën shpirtërore të dominimit dhe ligjit të kishës-mbretëri (Gjoni 18:36). Kisha është trupi i ndjekësve të Krishtit që i janë nënshtruar ligjit të Perëndisë në tokë. Krishti është Mbreti dhe po mbretëron tani mbi mbretërinë e Tij, kishën (1 Korintasve 15:24–25). Pra, kisha ka një udhëheqës apo mbret hyjnor dhe drejtohet prej Tij. Anëtarët e kishës i përulën autoritetit të Mbretit Jezus dhe jetojnë si «qytetarë» të mbretërisë së Tij shpirtërore (Filipianëve 3:20), edhe pse ata jetojnë në tokë.

Shprehjet e mësipërme të përdorura nga Fryma e Shenjtë

për t'iu referuar kishës nuk duhet të merren thjesht si ilustrime. Kisha është ilustruar shpesh në Testamentin e Ri. Për shembull, ajo është përshkruar si vatha e deleve (Gjoni 10:1), si vreshti (Mateu 20:1) apo si një perlë e çmuar (Mateu 13:45–46). Këto ilustrime na ndihmojnë që ta kuptojmë kishën më mirë, por ato janë vetëm ilustrime dhe jo terma të përdorura për të identifikuar kishën. Testamenti i Ri i quan ndjekësit besimtarë të Krishtit «kisha» e Tij: «trupi» i Tij dhe «mbretëria» e Tij.

### EMËRTIMI QË TREGON PRONËSI

Dy shprehjet që i referohen kishës në Testamentin e Ri theksojnë marrëdhënien e pronësisë që kisha ka me Perëndinë dhe me Krishtin. Këto shprehje na ndihmojnë të dallojmë me qartësi zotëruesin dhe drejtuesin e kishës.

Së pari, kisha emërtohet «kisha e Krishtit». Në përfundimin e letrës së Palit dërguar Romakëve, ai dërgon përshëndetje nga kishat e Akaisë duke thënë: «Kishat e Krishtit ju përshëndesin» (Romakëve 16:16b). Ky titull thekson zotërimin dhe identitetin e kishës. Kisha është kisha e Krishtit, sepse Krishti e themeloi, e bleu, e zotëron dhe Ai është kreu i saj. Kur dikush është konvertuar në Krisht, ai e përket Krishtit (1 Korintasve 6:20). Ai bëhet tërësisht kaq i identifikuar me Krishtin sa quhet kristian, ndjekës i Krishtit (Veprat 11:26, 26:28; 1 Pjetër 4:16). Kështu, bashkësia e ndjekësve të Krishtit është quajtur kisha e Krishtit për të treguar se e kujt është kisha, kush e zotëron atë dhe kush është pjesë e saj.

Së dyti, kisha është përmendur si «kisha e Perëndisë» (1 Korintasve 1:2). Në qoftë se kisha është përmendur në Testamentin e Ri si kisha e Krishtit, në të njëjtën mënyrë ne duhet ta mendojmë atë si kishën e Perëndisë, sepse Jezusi tha se Ai dhe Ati i Tij janë një (Gjoni 10:30). Perëndia e planifikoi kishën përpara themelimit të botës (Efesianëve 3:10–11). Ai dërgoi Krishtin në botë për të përgatitur

kishën (Mateu 16:18) dhe për ta blerë atë me gjakun e Tij (Veprat 20:28). Ashtu si ishte me Krishtin në kryq për të pajtuar botën me veten e Tij (2 Korintasve 5:19), në të njëjtën mënyrë Perëndia ishte me Krishtin edhe në themelimin dhe blerjen e kishës.

Përdorimi i emrave të ndryshëm për kishën është i qëllimshëm. Ai na ndihmon për të kuptuar identitetin e saj. Një nga ngjarjet më të këqija të jetës më ka ndodhur kur isha në klasën e gjashtë. Kisha qenë nga klasa e parë tek e pesta në të njëjtën ndërtesë dykatëshe, në një shkollë fshati. Kur isha në klasën e gjashtë, shkova në një shkollë të madhe në qytet, një shkollë me shumë klasa dhe mësues. Kjo lëvizje ishte një ndryshim i madh për mua. Mësuesja ime ishte shumë e mirë, por ajo aksidentalisht e kuptoi emrin tim gabim kur unë vajta për herë të parë në shkollë. Dhe për gjashtë muaj të tërë ajo më thërriste me emrin e gabuar. Unë isha i inatosur dhe i çoroditur. Më dukej vetja sikur isha një njeri tjetër. Disa herë isha gati t'i thoja: «Shqiptoje emrin ashtu siç duhet! Më thirr me emrin tim të vërtetë. Unë jam Edi, jo Çarli!»

Ka mënyra të veçanta për t'iu referuar kishës në Testamentin e Ri dhe ato duhet të përdoren. Ne ngatërrojmë identitetin e kishës kur përdorim emra jobiblikë për të. Në qoftë se një grup njerëzish kërkon që të jetë kishë e Testamentit të Ri dhe do që të njihet si kishë e Testamentit të Ri, ata duhet të përdorin emrat e dhënë në Testamentin e Ri për kishën. Një kishë mund të quhet kishë e Testamentit të Ri dhe mund të mos jetë kishë e Testamentit të Ri, por në qoftë se është me të vërtetë kisha e Testamentit të Ri, ajo duhet t'i referohet vetes me gjuhën e përdorur në Testamentin e Ri.

## MARRËDHËNIET E KISHËS

Katër mënyrat me të cilat Testamenti i Ri i referohet kishës theksojnë idenë e marrëdhënies. Kjo është e pritshme,

meqënëse të qenët anëtar i kishës së Perëndisë përfshin marrëdhënie të ndryshme.

Së pari, Testamenti i Ri e përshkruan kishën si «familjen e Perëndisë». Pali tha se kristianët janë «pjesëtarë të familjes së Perëndisë» (Efesianëve 2:19). Ai i tha Timoteut se po i shkruante për ta udhëzuar si të sillet në «shtëpinë e Perëndisë, që është kisha e Perëndisë së gjallë» (1 Timoteut 3:15). Kur dikush konvertohet në Krisht, Perëndia e adopton atë si fëmijën e Tij, duke i dhënë privilegjet e familjes dhe duke e bërë trashgimtar të jetës së përjetshme bashkë me Krishtin (Romakëve 8:15–17; Efesianëve 1:5). Kristianët kanë një At qiellor, të cilit mund t'i luten dhe kanë një Shpëtimtar të dashur, një vëlla më të madh, Jezusin, përmes të cilit mund t'i luten Perëndisë. Si vëllezër dhe motra, ata duan, ndihmojnë dhe inkurajojnë njëri-tjetrin (Veprat 2:44). Pra, anëtarët e kishës së hershme ishin vëllezër dhe miq (2 Pjetër 3:15; 3 Gjon 14).

Së dyti, kisha e shekullit të parë u quajt «dishepujt e Zotit» (Veprat 9:1). Fjala «dishepull» do të thotë nxënës ose ndjekës. Në Porosinë e Tij të Madhe, Krishti u tha apostujve të Tij të shkonin dhe të bënë dishepuj: «Shkoni, pra dhe bëni dishepuj nga të gjithë popujt...» (Mateu 28:19). Kristianët janë dishepujt e Krishtit. Disa herë kisha quhet thjesht «dishepujt» (Veprat 9:26, 11:26).

Fjala «dishepull» sugjeron marrëdhënien e vazhdueshme që ekziston midis kristianit dhe Perëndisë së tij. Dishepulli gjithmonë mëson nga Perëndia duke e imituar atë dhe duke marrë udhëzimet e Tij. Perëndia i tij është Mësuesi i tij (Gjoni 13:13) dhe ai është shërbëtori i Perëndisë së tij (Filipianëve 1:1).

E treta, kisha e Testamentit të Ri është quajtur «tempulli e Perëndisë». Pali u tha kristianëve në Korinth: «A nuk e dini ju se jeni tempulli i Perëndisë dhe se Fryma e Perëndisë banon në ju?» (1 Korintasve 3:16). Kisha, si një bashkësi kristianësh, krijon një vend banimi për Perëndinë. Vendi

ku banon Perëndia sot është një trup me jetë, është kisha e Tij. Kështu individët kristianë janë quajtur «shenjëtorë», sepse ata janë të zgjedhur nga ungjilli për të bërë punë të shenjta dhe për të siguruar një vend banimi për Perëndinë (1 Korintasve 1:2).

E katërta, Testamenti i Ri i referohet kishës në një varg si «kisha e të parëlindurve» (Hebrenjve 12:23). Kisha ka një marrëdhënie të veçantë me të ardhmen, sepse çdo anëtar i kishës është «regjistruar në qiell». E ardhmja për kristianët nuk është e frikshme apo e pasigurt. Kjo vjen nga shpresa e përjetshme që gjendet në Krishtin.

Ky realitet i marrëdhënieve të kishës, na ndihmon të kuptojmë më mirë se çfarë është kisha dhe mënyrën se si ajo duhet të jetojë. Ai u tregon kristianëve se si të jetojnë në tokë dhe tregon se si të shpëtuarit do të takohen me Perëndinë në të ardhmen.

Perëndia e ndryshoi emrin e Abramit në Abraham, sepse emri Abram nuk i përshtatej më atij. Abramit ju tha se ai do të bëhej babai i një shumice kombesh (Zanafilla 17:5). Emri Abram do të thotë «at i gëzuar». Abram ishte një emër me kuptim, por nuk përfaqësonte të ardhmen që Abrami do të kishte. Emri Abraham do të thotë «ati i shumicës», emri i duhur për një njeri që do të ishte ati i një kombi. Emri që Perëndia i dha Abrahamit, ishte domethënës për Perëndinë dhe për Abrahamin. Në të njëjtën mënyrë, emri që Perëndia i ka dhënë kishës, është domethënës për Perëndinë dhe duhet të jetë domethënës edhe për ne sot.

## KONKLUZIONI

Dikush mund të pyesë: «Pse do të interesohej Perëndia për emërtimin e kishës?» Përgjigjja është e qartë. Këto emërtime identifikojnë, karakterizojnë dhe përshkruajnë kishën. Plani i Perëndisë që nga përjetësia, misioni i Jezusit në tokë dhe dhuratat e sakrificës së Jezusit në kryq janë përmbushur të gjitha në themelimin e kishës. Sa e shtrenjtë

duhet të jetë kisha për Perëndinë! A guxojmë ne t'i referohemi kishës së Tij me emra të ndryshëm nga emrat që Ai vetë i zgjodhi?

Vendosmëria për të qenë kisha e Perëndisë sot duhet të tregohet madje edhe në mënyrat që anëtarët emërtojnë dhe përshkruajnë veten e tyre. Përdorimi i emrave që përdori Perëndia për Kishën e Tij është së paku një pikë fillimi për kristianët që përpiqen të praktikojnë në jetët e tyre planin e Perëndisë për kishën e Tij. Kur kristianët e emërtojnë veten e tyre me emra të zgjedhur nga Perëndia për kishën e tij, ata e vendosin veten e tyre në rrugë të drejtë, duke shkuar drejt asaj që Perëndia dëshiron për ta. (Shikoni mësimin “Shtojca 3”.)

## PËRGJIGJUNI PYETJEVE

(përgjigjet në mësimin “Shtojca 1”)

1. Përmendni ngjarjet që udhëhoqën themelimin e kishës.
2. Përmendni frazat biblike që i referohen funksioneve të kishës.
3. Si është përdorur fjala «mbretëri» në Testamentin e Ri në lidhje me kishën?
4. Pse Pali i referohet kishës si «kisha e Krishtit»? Çfarë emrash të tjerë për kishën sugjerojnë pronësinë?
5. Pse duhet të përdorim emërtimet që janë dhënë në Testamentin e Ri për kishën?
6. Përmendni emrat biblikë për t'iu referuar kishës që theksojnë marrëdhëniet e saj.
7. Pse kisha është quajtur «familja e Perëndisë»?
8. Çfarë realizohet kur e emërtojmë kishën me emra biblikë?

Autor: *Eddi Cloer*

Marrë nga libri: “*Si të bëhesh një kristian besnik*”

© 2002 E VERTETA PER SOT

Të gjitha të drejtat të rezervuara